

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7050
E premte, 17 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Qeveria miraton shtesat e rrezikshmërisë për policët | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA DISKUTUAR TË ENJTEN PËR PROJEKTLIGJIN
PËR NDARJET BUXHETORE PËR VITIN 2024 | FAQE 4-5

KURTI THOTË SE BUXHETI I 2024-S ËSHTË PËR NJË EKONOMI TË FORTË, OPOZITA E QUAN BUXHET I VARFËRISË



Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro. Për të në Kuvendin e Kosovës është diskutuar të enjten. Deputetët e

partive opozitare kanë shprehur kritika për këtë buxhet, duke e cilësuar buxhetin i varfërisë dhe diskriminues për komunat që nuk qeverisen nga Lëvizja

Vetëvendosje. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se buxheti i vitit 2024 do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve për një ekonomi të fortë

DELEGACIONI I KOSOVËS
DHE AI I SERBISË
DISKUTOJNË ME
ZYRTARËT E BE-SË, POR
JO ME NJËRI-TJETRIN, NË
QENDËR TË DISKUTIMEVE
ASOCIACIONI | FAQE 3



BIDENI,
IZRAELIT:
PUSHTIMI I
GAZËS DO TË
ISHTË 'GABIM
I MADH' | FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



MACRONI: TENSIONET NË KOSOVË
JANË ULUR PAK | F. 3

HALITJAHA: SHITABI I PËRGJITHSHËM
KA QENË THUAJSE FIKTIV,
URDRHRAT NUK VININ AS
NGA THAÇI AS NGA TË TJERËT | F. 5

VARHELYI TAKON KRASNIOQIN NË
BRUKSEL: SITUATA NË VERI TË
ZGJIDHET ME PRIORITET | F. 7

EKONOMI



VLERE E INVESTIMEVE TË BQK-së
NË LETRA ME VLERË DHE DEPOZITA
ARRIN NË 1.14 MILIARD EURO | F. 8

CILËSIA E UJIT NË LIQENIN E
BADOCIT ËSHTË PËRMIRËSUAR,
POR ENDE DUHET TË ULEN VLERAT
E MANGANIT | F. 8

SPORT



'DARDANËT' SOT UDHËTOJNË
DREJT BAZELIT, KRASNIOQI DHE
AJDINI BESOJNË NË FITORE | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni, Izraelit: Pushtimi i Gazës do të ishte 'gabim i madh'

WASHINGTON, 16 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se ia ka bërë të qartë kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu se zgjidhja me dy shtete është përgjigja e vetme për ta zgjidhur konfliktin izraelito-palestinez dhe që pushtimi i Gazës përbën "gabim të madh".

Bideni u ka thënë gazetarëve se ai është duke bërë gjithçka që mundet për t'i liruar pengjet që po mbahen nga Hamasi, grup palestinez i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Megjithatë, Bideni ka thënë nuk mëton ta dërgojë ushtrinë amerikane atje.

Presidenti Biden u ka thënë gazetarëve këtë javë se mesazhi i tij për pengjet është "duroni, po vijmë", duke ngritur pikëpyetje se çka ka nënkuptuar me këtë fjali.

I pyetur për më shumë sqarime, Bideni ka thënë se "ajo çfarë kam menduar ka qenë që po bëj gjithçka për t'i liruar. Nuk kam qenë duke folur për ushtrinë".

Bideni ka thënë se është duke punuar në këtë çështje

vazhdimisht, dhe nuk do të ndalet derisa të lirohen pengjet. Katari, ku Hamasi e ka zyrën politike, është në krye të përpjekjeve për ndërmjetësim në mes të grupit radikal dhe zyrtarëve izraelitë për lirim të mbi 240 pengjeve.

Ata janë marrë prej militantëve, teksa kanë kryer sulm më 7 tetor në Izrael.

Autoritetet izraelite kanë thënë se 1 200 njerëz janë vrarë si pasojë e atyre sulmeve.

Izraeli më pas i ka shpallur luftë Hamasit, që kontrollon Rripin e Gazës.

Sipas autoriteteve palestineze, mbi 11 000 njerëz janë vrarë si pasojë e sulmeve izraelite në Gazë dhe rreth 40 për qind e tyre janë fëmijë.

Bideni ka thënë se Hamasi është duke kryer krime lufte, duke pasur seli ushtarake nën një spital, dhe e ka përsëritur deklaratën e një zëdhënësi të Shtëpisë së Bardhë, se është i bindur për këtë "fakt" të mbështetur prej inteligjencës amerikane.

Ai ka thënë se ushtria izraelite ka hyrë në spitalin më të madh



të Gazës, Al Shifa, me një numër të kufizuar të trupave ushtarake me armë. "Atyre u kemi thënë që duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm", ka thënë Bideni, duke shtuar se Izraeli ka obligim të jetë sa më i kujdesshëm teksa gjurmon shënjestrat.

Mirëpo ka thënë se "nuk është realiste" të presë që Izraeli t'u japë fund aksioneve ushtarake,

duke marrë parasysh kërcënimet e një zyrtari të Hamasit që ata synojnë t'i përsëritin sërish sulmet ndaj Izraelit. "Hamasit tashmë ka thënë publikisht se planifikon ta sulmojë sërish Izraelin, sikurse ka vepruar më parë, ku ka prerë kokat e foshnjave", ka thënë Bideni, i cili muajin e kaluar ka thënë se ka parë fotografi të foshnjave pa kokë.

Shtëpia e Bardhë ka sqaruar muajin e kaluar se zyrtarët amerikanë nuk kanë të dhëna për një pretendim të tillë, dhe se Bideni është duke iu referuar raportimeve në medie.

Ende nuk është e qartë nëse informacionet e reja të ShBA-së kanë konfirmuar që foshnjave u është prerë koka.

Të mërkurën Bideni ka thënë se Izraeli do të dërgojë inkubatorë dhe pajisje të tjera për t'u ndihmuar njerëzve dhe që ushtarët e tij po u japin mundësi mjekëve dhe stafit mjekësor "të largohen pa u lënduar".

Izraeli ka thënë të mërkurën se trupat ushtarake të tij kanë gjetur armë të Hamasit dhe pajisje ushtarake në spitalin Al Shifra gjatë bastisjeve.

Hamasit i ka konsideruar këto pretendime si gënjeshtër.

Bideni ka thënë se i ka thënë Netanyahu që nuk beson se lufta do të përfundojë derisa të arrihet një zgjidhje mes dy shteteve. "E kam bërë të qartë për Izraelin, që besoj se është gabim i madh për të ta pushtojë Gazën", ka thënë presidenti amerikan.

Zelensky e Cameroni diskutojnë për mbështetjen e mëtejme britanike për Ukrainën

KIEV, 16 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka biseduar të enjten me sekretarin e jashtëm britanik, David Cameron, për mbështetjen e mëtejme të ushtrisë britanike për Ukrainën.

Cameroni, ish-kryeministër britanik, i cili është emëruar në pozitën e sekretarit të jashtëm, më 13 nëntor e ka vizituar Kievin për ta treguar mbështetjen britanike për Ukrainën, teksa lufta në Gazë rrezikon ta tërheqë vëmendjen globale prej luftës së Rusisë ndaj fqinjës së saj.

Në njoftimin e Zelenskyt, i cili ka ardhur pas një vale të sulmeve ruse me dronë në Ukrainë, nuk janë dhënë informacione se kur është zhvilluar vizita e Cameronit. "Ne kemi pasur takim të mirë, të fokusuar në armët në front të luftës, kemi diskutuar për forcim të



mbrojtjes ajrore dhe mbrojtje të njerëzve dhe infrastrukturës kritike", është cituar të ketë thënë Zelensky në "X" - platformë e

njohur më parë si "Twitter". "Bota nuk është aq e fokusuar në situatën në fushëbetë në Ukrainë, dhe kjo tërheqje e

fokusit nuk është duke ndihmuar", ka thënë Zelensky.

Camroni, në anën tjetër, ka thënë se vizita e tij ka për qëllim ta sigurojë Kievin për "mbështetjen morale, mbështetjen diplomatike mirëpo, mbi të gjitha, mbështetjen ushtarake që i duhet jo vetëm këtë vit dhe vitin tjetër, por aq sa të ketë nevojë", për Ukrainën, në përpjekjet e saj për ta luftuar agresionin rus.

Më 15 nëntor Zelensky ka thënë se Ukraina nuk mund ta përballojë një bllokadë në luftën kundër Rusisë. "Nëse ne dëshirojmë t'i japim fund luftës, ne duhet ta përfundojmë atë", ka thënë ai në një intervistë për gazetarët afrikanë. Sipas Zelenskyt, nëse lufta bllokohet, gjeneratat e ardhshme të ukrainasve do të duhet të luftojnë sepse Rusia "do të vijë

sërish, nëse nuk i tregohet vendi".

Mbrojtja ajrore ukrainase ka thënë përmes një deklaratë, më 16 nëntor, se i ka rrëzuar 16 prej 18 dronëve të prodhuar nga Irani, të lansuar nga Rusia përgjatë natës. Në deklaratë është thënë se alarmet janë lëshuar në shumë rajone ukrainase, pa e specifikuar numrin.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Mali i Zi sekuestron drogë dhe arreston një shtetas shqiptar

PODGORICË, 16 NËNTOR - Policia kufitare e Malit të Zi tha se ka parandaluar kontrabandën e 18 kilogramëve kokainë në vendkalimin Debeli Brijeg, në kufi me Kroacinë. Sipas njoftimit, rreth një orë pas mesnatës së 16 nëntorit u arrestua shtetasi shqiptar A. H., 34 vjeç, që drejtonte një

makinë të tipit BMW me targa franceze. "Përmes kontrollit të detajuar të mjetit, në një bunker të prodhuar enkas, u gjetën dhe sekuestruan 18 pako me lëndë pluhuri të bardhë, e dyshuar si kokainë, me peshë totale rreth 18 kilogramë. Droga e sekuestruar do të jetë subjekt

i një ekspertize në Qendrën e Mjekësisë Ligjore", thuhet në njoftimin e policisë malazeze. Aty shtohet se me urdhër të prokurorit të shtetit, A. H. u arrestua nën dyshimin se ka kryer veprën penale të prodhimit, posedimit dhe shpërndarjes së paautorizuar të narkotikëve.



Delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë diskutojnë me zyrtarët e BE-së, por jo me njëri-tjetrin, në qendër të diskutimeve Asociacioni

Kosova dhe Serbia kanë diskutuar të enjten në Bruksel në nivel kryenegociatorësh për zbatimin e marrëveshjes së arritur më herët gjatë këtij viti për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Në qendër të diskutimeve ishte projekt-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

BRUKSEL, 16 NËNTOR - Kryenegociatorët e Kosovës dhe të Serbisë kanë zhvilluar të enjten takime në Bruksel rreth zbatimit të marrëveshjeve paraprake të arritura mes dy vendeve.

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun mes dy vendeve, Mirosllav Lajçak, është takuar fillimisht me kryenegociatorin e Serbisë, Petar Petkoviç, njëherësh shef i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, më pas me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i vendit. Takim trepalësh nuk ka pasur. Në qendër të diskutimeve ishte projekt-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. BE-ja ka bërë me dije se paralelisht janë zhvilluar edhe takime ekspertësh për të pagjeturit dhe për çështje të energjisë.

Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka konfirmuar se në takim me Lajçakun është diskutuar për një plan të sekuencuar të zbatimit të marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve si dhe për aneksin e zbatimit. Palët kanë arritur pajtueshmëri për këtë marrëveshje në shkurt në Bruksel, ndërsa për aneksin e zbatimit, në mars në Ohër. "Gjatë javës së kaluar, z. Lajçak na e ka sjellë një draft të ri, i cili e fut për herë të parë paralelizmin e plotë në zbatimin e marrëveshjes, apo zbatim më të balancuar, dhe ne jemi përpjekur që për këtë draft t'i japim komentet finale, në

mënyrë që i njëjti të jetë i pranueshëm edhe për palën tonë. Mendoj se ka pasur gatishmëri të madhe të Lajçakut që t'i akomodojë propozimet tona dhe të gjitha janë argumentuar mirë", ka thënë Bislimi pas takimit.

I pyetur nëse është diskutuar për draft-statutin për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë - të dorëzuar nga një delegacion perëndimor javë më parë në Prishtinë e Beograd - Bislimi ka thënë se kjo pikë ka qenë në agjendë, por pala e Kosovës e ka bërë të qartë qëndrimin e vet. Ai ka thënë se duhet të ketë nënshkrim të draft-statutit dhe marrëveshjes për normalizim në mënyrë që ato të zbatohen. "Nuk mund të nisë zbatimi [pa nënshkrim], sepse duhet garancia që kemi një marrëveshje valide, që sjell obligime edhe për palën tjetër". I pyetur nëse qëndron deklarimi i zyrtarëve evropianë se draft-statuti i paraqitur është versioni më i mirë që ka pranuar Kosova, Bislimi ka thënë se një qëndrim i tillë është subjektiv, sepse "Kosova nuk ka pasur deri më tani oferta". "Kemi pasur draftë që kanë qarkulluar, por mund të themi që drafti që i është dorëzuar Kosovës nga miqtë tanë të Bashkimit Evropian dhe të ShBA-së, gjatë përgatitjes së neneve të veta, ka pasur një kujdes të shtuar për provizionet kushtetuese të Kushtetutës së Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se çështja nëse ai dokument është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës vendos Gjykata



Kushtetuese.

Takimi i 16 nëntorit është vazhdimësi e takimit të zhvilluar më 26 tetor me liderët e Gjermanisë, Francës, Italisë dhe bllokut evropian.

Petkoviç ka thënë ditë më parë se në Bruksel do të nisët me një "ekip ekspertësh".

Sipas burimeve evropiane, në agjendë të takimeve ka qenë diskutimi për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, por edhe për hapat e tjerë në zbatimin e obligimeve që dalin prej Marrëveshjes për Normalizim të Marrëdhënieve mes dy vendeve.

Palët kanë arritur pajtueshmëri për këtë marrëveshje në shkurt në Bruksel, ndërsa për aneksin e zbatimit, në mars në Ohër, ku pjesë e saj është edhe Asociacioni.

Drafti për këtë Asociacion u është dorëzuar palëve në tetor nga një delegacion i përbashkët i Shteteve të Bashkuara, BE-së, Gjermanisë, Italisë dhe Francës. BE-ja e konsideron këtë draft si "plan modern evropian" dhe ka insistuar që palët ta pranojnë. Ndonëse përmbajtja e këtij drafti

vazhdon të mos jetë e qasshme për publikun, BE-ja dhe vendet kryesore anëtare e konsiderojnë atë si propozimin më të mirë dhe si kompromis të cilin palët duhet ta shfrytëzojnë për të lëvizur përpara.

Komisioni Evropian i ka kritikuar Kosovën dhe Serbinë për mungesë gatishmërie për t'i zbatuar obligimet që dalin prej marrëveshjeve paraprake.

Në Raportin e Progresit të këtij Komisioni është konstatuar se palët nuk kanë nisur fare ta zbatojnë Marrëveshjen Drejt Normalizimit.

Në këtë raport, Komisioni Evropian ka bërë ftesë për Kosovën dhe Serbinë që t'u qasen më me përgjegjësi obligimeve nga dialogu, duke rikujtuar se diçka e tillë është kyçe për përparimin e tyre në procesin e integritimeve evropiane.

Në takimet e fundit që kanë pasur liderët e Kosovës dhe të Serbisë me liderët e BE-së, Francës, Gjermanisë e Italisë në Bruksel, më 26 tetor, ata, sipas diplomatëve evropianë, "kanë shprehur gatishmëri ta pranojnë propozimin si bazë të mirë".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shprehur gatishmëri të ecë përpara me këtë propozim, si dhe me zbatim të Marrëveshjes për Normalizim. Ai ka thënë se ka dashur ta nënshkruajë dokumentin, pasi "vetëm nënshkrimi nënkupton pranim dhe garanton implementim".

Por, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka refuzuar ta nënshkruajë atë.

Në BE besojnë se takimet e së enjtes do ta hapin rrugën për një dinamikë të re në procesin e zbatimit të marrëveshjeve.

Marrëveshja për normalizim, prej 11 nënesh, mes të tjerash, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Kosova dhe Serbia janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizim të raporteve që prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjes, por jo të gjitha janë zbatuar.



Macroni: Tensionet në Kosovë janë ulur pak

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, së bashku me presidentin e Konfederatës Zvicerane, Alain Berset, gjatë një paraqitjeje para studentëve në Universitetin e Lozanës, është pyetur edhe lidhur me situatën Ballkan, rrjedhimisht tensionimin e situatës në Kosovë pas sulmit në Banjskë të Zveçanit nga një grup terrorist.

Siç njofton "24heures", Macroni, i pyetur për tensionimin e situatës në Kosovë, ka thënë se "tensionet aktualisht janë ulur

pak".

Ai shpreson se liderët e dy "kampeve" të ndryshme, duke aluduar në kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do ta ndjekin "udhërrëfyesin" që është vendosur.

Presidenti francez, po ashtu, ka thënë se është i shqetësuar, por jo i frikësuar për rifillimin e konfliktit në Kosovë. "Jam i shqetësuar, por nuk kam frikë nga rifillimi i konfliktit në Kosovë", ka përfunduar Macroni.



KUVENDI I KOSOVËS KA DISKUTUAR TË ENJTEN PËR PROJEKTLIGJIN PËR NDARJET BUXHETORE PËR VITIN 2024

Kurti thotë se buxheti i 2024-s është për një ekonomi të fortë, opozita e quan buxhet i varfërisë

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro. Për të në Kuvendin e Kosovës është diskutuar të enjten. Deputetët e partive opozitare kanë shprehur kritika për këtë buxhet, duke e cilësuar buxhet i varfërisë dhe diskriminues për komunat që nuk qeverisen nga Lëvizja Vetëvendosje. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se buxheti i vitit 2024 do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve për një ekonomi të fortë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka diskutuar të enjten për Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2024. Projektligji është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 31 tetor, ndërsa shuma e paraparë buxhetore kap vlerën e mbi 3.3 miliardë eurove - nga 3.2 miliardë sa ishte në këtë vit. Nga kjo shumë, mbi 1 miliard euro parashihet të shkojnë për subvencione dhe transfere, mbi 850 milionë euro për shpenzime

kapitale, mbi 800 milionë euro për paga dhe shtesa dhe afër 500 milionë euro për mallra dhe shpenzime.

Pesë institucionet me buxhetin më të madh në vitin 2024 pritet të jenë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 931.025.963 euro, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 265.445.995 euro, Ministria e Punëve të Brendshme me 216.523.467 euro, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me 174.387.768 euro dhe Ministria e Mbrojtjes me

153.049.911 euro.

Sipas Qeverisë së Kosovës, buxheti do të rritet në disa sektorë vitin e ardhshëm, përfshirë: sigurinë, shëndetësinë, ekonominë dhe arsimin.

Buxheti i vitit 2024 parasheh edhe rritjen e koeficientit të pagave nga 105 euro sa është aktualisht - në 110. Ndër vite një pjesë e madhe e buxhetit të shtetit ka shkuar për sektorin e sigurisë.

Kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij para deputetëve ka theksuar se buxheti i vitit 2024 do të jetë prioritet në programin e tyre qeverisës sa iu përket nevojave të qytetarëve për një ekonomi të fortë, me më shumë vende të punës; për shëndetësi gjithëpërfshirëse me shërbime më të mira; arsim të zhvilluar me cilësi më të lartë; e sundim të ligjit me drejtësi të reformuar.

Buxheti i komunave nga 547 milionë euro sa ishte në vitin 2021, do të rritet në 654 milionë euro në vitin 2024, tha Kurti, duke aluduar në periudhën e qeverisjes së tij.

"Buxheti i komunave në vitin

2021 ishte 547 milionë euro. Sivjet është 654 milionë euro. Në vitin 2024 ai do të jetë gati 200 milionë më shumë sesa në vitin e parë të qeverisjes sonë, ose 742 milionë euro, prej të cilave 635 milionë euro janë grant për komunat nga qeveria, kurse pjesa tjetër janë të hyra vetjake të komunave. Pra ky buxhet i qeverisë është, po ashtu, edhe buxhet i komunave", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se buxheti i vitit të ardhshëm përsëri do të jetë edhe buxhet për shqiptarët e Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. "Atij po ia shtojmë edhe një milion, krahasuar me vitin aktual, pra nga dy në tre milionë euro për vitin 2024. Kjo mbështetje është më e larta ndonjëherë, dhe është më shumë se të gjitha qeveritë paraprake marrë së bashku", ka deklaruar Kurti, duke kërkuar votën e deputetëve për votimin e këtij projektligji. "Me projektbuxhetin për vitin 2024 forcojmë mbrojtjen e Republikës, e rrisim sigurinë e qytetarëve dhe e mundësojmë zhvillimin e vendit

e mirëqenien e popullit. Andaj ju ftoj secilën dhe secilin prej juve që me votën tuaj ta mbështetni", ka thënë Kurti.

Por, deputetët e partive opozitare e kanë kritikuar buxhetin e paraparë për vitin e ardhshëm.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ky buxhet ka shpërputhje me zotimet që i ka qeveria. Sipas tij, ka shpërputhje me prioritetet ekonomike dhe ka shpërputhje me nevojat emergjente që i kanë qytetarët.


Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, në adresimin e tij para deputetëve, ka akuzuar qeverinë Kurti për diskriminimin e komunave të cilat nuk qeverisen nga Lëvizja Vetëvendosje. Ai ka thënë se qeveria Kurti ka përdorur kriter politik kur ka vendosur ta ndajë buxhetin për investime kapitale për komunat.

Shala ka thënë se me buxhetin e ri investimet e reja për komuna janë si vijon: Gjilan 22.24 për qind, Prishtinë 7.03 për qind, Shtime 7.63 për qind, Mitrovicë 5.02 për qind, Kamenicë 6.86 për

Halitjaha: Shtabi i Përgjithshëm ka qenë thujtë fiktiv, urdhrat nuk vinin as nga Thaçi as nga të tjerët

HAGË, 16 NËNTOR - Sadik Halitjaha, gjatë dëshmisë së tij në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), ka thënë se urdhrat nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk u shkronin as nga Hashim Thaçi e as nga personat e tjerë.

Gjatë dëshmisë së tij në çështjen gjyqësore ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Halitjaha tha se Shtabi i Përgjithshëm ka qenë thujtë fiktiv. "Urdhrat nuk vinin as nga Hashim Thaçi, por nuk vinin as nga të tjerët, mjerisht që ne kemi pritur e kemi idealizuar një Shtab të Përgjithshëm i cili duhet të jetë krejt funksional, i cili duhet ta ketë nivelin më të lartë të detyrës dhe i cili realisht ka qenë gati thujtë fiktiv. Thujtë fiktiv me shumë pak njerëz. Nuk besoj që Hashim Thaçi ka pasur 2-3 vetë, jo më shumë rreth vetes, dhe nuk ka mundur ta bëjë edhe punën që ka pasur të bëjë për detyrë si duhet por, sidoqoftë, urdhrat nuk kanë ardhur prej Hashim Thaçit", tha Halitjaha.



Dëshmitarit Halitjaha iu prezantua edhe një fragment i librit të tij ku kishte thënë se sa i takon Drejtorisë Politike pranë shtabit kishte pak njerëz dhe kuadro që, po ashtu, ishin pa

përvojë. "Të kthehemi te libri juaj, dëshmitar. Këtu thoni që sa i takon Drejtorisë Politike të formuar, ju thoni që..., ndërkaq u formua dhe u organizua Drejtoria Politike pranë shtabit e

cila ishte e paktë me njerëz dhe kuadro dhe, po ashtu, e papërvojë por, megjithatë, pati rol të rëndësishëm në kontaktet e zhvillimet diplomatike që u zhvilluan më vonë si brenda

Kosovës dhe në Rambuje. Në kohën kur Hashim Thaçi mori këtë rol, sipas mendimit tuaj, dëshmitar, ai ishte i ri dhe i papërvojë, shumë i papërvojë", tha avokati i Thaçit, Gregory Keohe, teksa po shpjegonte fragmente nga libri i Halitjahës.

Në përgjigje të kësaj, Halitjaha tha se të gjithë kanë qenë pa përvojë, mirëpo në të gjitha takimet e nivelit politik ka qenë përfaqësues Hashim Thaçi. "Ne ndoshta të gjithë kemi qenë pa përvojë, se kemi qenë në përballje lufte që për herë të parë ndodhin disa gjëra në jetë, por kontaktet me Tina Kajdanoven, Hoolbroukin dhe të gjithë përfaqësuesit që kanë ardhur të takojnë kanë qenë të nivelit politik. Ato i ka përfaqësuar presidenti Thaçi".

Dëshmitari Halitjaha gjatë dëshmisë së tij ka thënë se ai është i gatshëm të mbajë burgun në vend të Jakup Krasniqit nëse ky i fundit ka ndonjë faj, duke kërkuar që ai të lirohet.

Urdhërohet riklasifikimi i provave të pranuar nga dëshmitari Gjergj Dedaj në çështjen gjyqësore ndaj Thaçit dhe të tjerëve

Hagë, 16 nëntor - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) është bërë riklasifikimi i disa provave të cilat janë pranuar nga dëshmitari me kodin 03825, si prova materiale publike në çështjen gjyqësore ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Ky urdhër është marrë nga kryetari i trupit gjykues, Charles Smith III. Në këtë çështje, kodin e tillë e mbante dëshmitari Gjergj Dedaj. "Lidhur me riklasifikimin e provave të caktuara materiale të cilat i janë parashtruar në kuadër të dëshmitarit 03825. Trupi gjykues është informuar që palët janë pajtuar ndërmjet tyre 'interpartes' që provat materiale të caktuara të pranuar nga dëshmitari 03825 mund të riklasifikohen si prova materiale publike, kështu që trupi gjykues urdhëron që



provat materiale P681, 682, 683, 84 dhe 86 të riklasifikohen

si prova materiale publike", tha gjyqtari Smith III.



Trendafilova e Speciales viziton Kosovën në fund të muajit

Prishtinë, 16 nëntor - Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova, do të qëndrojë për vizitë në Kosovë në fund të këtij muaji. Ajo pritet ta mbajë një takim me organizatat e

shoqërisë civile të cilat do t'i informojë për zhvillimet dhe punën e Gjykatës Speciale dhe do t'u përgjigjet pyetjeve të tyre. Trendafilova do ta mbajë edhe një konferencë për medie.

qind, Kaçanik 2.09 për qind, Podujevë 6.13 për qind, Prizren 2.09 për qind, Vushtrri 2.01 për qind, Drenas 0.05 për qind dhe Skenderaj 0.04 për qind.

Më tutje, ai ka thënë se afër 32 për qind e buxhetit është për ndihma sociale. "Pra edhe në këtë buxhet është e njëjta logjikë, buxhet i varfërisë dhe buxhet social. Ose lirisht mund ta quajmë buxhet për zgjedhjet e ardhshme, nisur nga fakti se 1.1 miliard euro janë

subvencione", ka thënë Shala. Deputeti Shala ka kritikuar qeverinë Kurti edhe për zvogëlimin e buxhetit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së dhe për arsimin. "Krahasuar me vitin 2023, ka një rënie prej 3.39 milionë eurosh më pak. Pra rriten shpenzimet për mallra dhe shërbime, ndërsa zvogëlohen për pensionet dhe kompensimet për veteranët dhe invalidët e luftës", ka thënë Shala, i cili ka dhënë

edhe disa rekomandime për qeverinë në raport me buxhetin. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se rritja e buxhetit për më shumë se 100 milionë euro vitin e ardhshëm, është "zvogëlim real i buxhetit" kur khet parasysh shkalla e inflacionit. Ai rekomandoi që në buxhetin e vitit 2024 të ketë një pako për të rinjtë e Kosovës që, siç tha, të mos e lëshojnë vendin

nga 1 janari, kur edhe pritet liberalizimi i vizave.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se me një lexim të kujdesshëm shihet qartë se me këtë dokument qeveria ka goditur shtyllat vitale të ekonomisë. "E ka kthyer buxhetin në skema sociale jo për ta përmirësuar jetën e pensionistëve e as të punësuarve në institucione shtetërore, por duke e shkepur parandë publike

për qëllime elektorale. Shpejt ju vjen fundi edhe juve. Ju shkuan 3 vjet e kryhet edhe viti 2024. Turp!", ka thënë Tahiri.

Vitin e kaluar Kosova e ka mbyllur me një normë mesatare inflacioni prej 11.6-përqindësh, ndërsa këtë vit ajo ka qenë në rënie. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma e inflacionit në tetor ka qenë 3.3 për qind, në shtator 4.2 për qind, në gusht 3.2 për qind.

Në Vushtrri rinovohet objekti i Brigadës së Zjarrfikësve

VUSHTRRI, 16 NËNTOR - Komuna e Vushtrrisë ka bërë renovimin e tërësishëm të objektit të Brigadës së Zjarrfikësve. Këtë lajm e ka dhënë kryetari i kësaj komune, Ferit Idrizi, i cili ka

thënë se ky është investimi i radhës për përmirësimin e kushteve të punës së zjarrfikësve, pas investimeve në pajisje dhe automjete. "Pas investimeve në pajisje dhe automjete, si komunë

kemi rinovuar objektin e Brigadës së Zjarrfikësve në Vushtrri, ku tashmë heronjtë tanë do të kenë një objekt dinjitoz të punës", ka shkruar Idrizi në "Facebook".



Në Mitrovicë u mbajt sesion informues mbi mundësitë e kompanive vendore në panairët gjermane 2024

MITROVICË, 16 NËNTOR - Në Kuvendin Komunal të Mitrovicës është mbajtur sesion informues me temën: "Mundësitë e aplikimit dhe pjesëmarrjes së kompanive vendore në panairët që organizohen në Gjermani në vitin 2024".

Në këtë takim ishin të pranishëm drejtori për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Elvis Feka, udhëheqësja e Departamentit për Mbështetje dhe Shërbime të Anëtarëve në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, Besarta Hyseni, dhe zëvendësuesi i udhëheqësit të Sektorit për Promovim të Eksportit në KIESA-s, Mirsad Simnica. Drejtori Feka ka mbajtur fjalën

hyrëse për këtë sesion, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së kompanive lokale në panairët gjermane dhe potencialin e tyre për zhvillim dhe ndërveprim në tregun ndërkombëtar. Ai ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike për përmirësimin e mundësive për pjesëmarrje.

Ndërsa Hyseni ka paraqitur shërbimin e Senior Expert Service (SES), duke theksuar se ky shërbim ofron ndihmë eksperte nga profesionistët gjermanë për kompanitë që duan t'i përmirësojnë dhe zgjerojnë aktivitetet e tyre në tregun ndërkombëtar.



Miratohet vendimi për shpronësimin e "Damperit" në Suharekë, kalon në pronësi të FSK-së

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Në mbledhjen e së enjtes të qeverisë është miratuar vendimi për shpronësimin e "Damperit" në Suharekë. Me paratë e

shpronësimit do të kompensohen ish-punëtorët e fabrikës "Ballkani". Prona tash kalon në pronësi të FSK-së. Kryeministri i vendit, Albin Kurti,

ka thënë se me përfundimin e procedurës së shpronësimit do të kompensohen në vlerën prej 20-përqindësh punëtorët e ish-fabrikës së "Ballkani"-t.



Fillon transformimi i pjesës së frekuentuar të qytetit, bulevardi "Ilaz Kodra" në Skenderaj

SKENDERAJ, 16 NËNTOR - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se ka filluar transformimi i pjesës së frekuentuar të qytetit, bulevardi "Ilaz Kodra", ku ka filluar rrënimin e objekteve ekzistuese, për t'u zëvendësuar me objekte moderne, në të cilat

operatorët biznesorë do të kenë kushte shumë më të mira ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike. Pjesë e këtij projekti është edhe ndërtimi i tribunës veriore të Stadiumit "Bajram Aliu", në funksion të zbatimit të planit rregullativ të qytetit të Skenderajt.

Latifi edhe këtë të enjte priti në takim qytetarët

RAHOVEC, 16 NËNTOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, edhe këtë të enjte ka

hapur dyert e zyrës për qytetarët. Komuna ka njoftuar se "duke pasur mundësi të kontribuojnë

në mënyrë aktive dhe direkte në mirëqenien e tyre, qytetarët e komunës së Rahovecit, çdo të enjte

takohen me kryetarin Latifi për të bashkëbiseduar rreth kërkesave të ndryshme".



Varhelyi takon Krasniqin në Bruksel: Situata në veri të zgjidhet me prioritet

BRUKSEL, 16 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, gjatë vizitës në Bruksel është takuar me komisionarin e Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi. "Bashkë diskutuam për procesin e integritimit evropian të Kosovës dhe rëndësinë që shteti ynë të mos lihet mbrapa

në këtë proces. Për shtetin dhe qytetarët tanë, është tejet e nevojshme që perspektiva evropiane të jetë e qartë dhe e prekshme. Për PDK-në, anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian dhe institucionet euroatlantike, është vizioni, misioni dhe rruga e vetme përpara", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Për këtë takim ka njoftuar edhe Varhelyi në rrjetin social "X". "Diskutua me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, për të ardhmen e Kosovës në rrugën e saj drejt BE-së. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është thelbësor për të mundësuar përparimin. Situata në veri të Kosovës duhet të zgjidhet me prioritet", ka shkruar Varhelyi.



Qeveria miraton shtesat e rrezikshmërisë për policët

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar shtesat e rrezikshmërisë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës në mbledhjen e mbajtur të enjten. Ekzekutivi ka ndarë shumën e shtesave në shtatë kategori, varësisht prej pozitave të zyrtarëve në Policinë e Kosovës.

Qeveria i kishte paraqitur më 27 tetor shtesat për rrezikshmërinë për pjesëtarët e policisë. Për njësitë elitare, përkatësisht për Njësinë Speciale Intervenuese, Njësinë për Ndërhyrje të Shpejtë dhe Njësinë për Mbrojtje të Afërt, shtesat do të jenë prej 150 eurosh mbi pagën bazë.

Ndërkaq për Njësinë për Eksplozivët dhe Çminim, qeveria ka thënë se shtesa do të jetë në vlerë prej 120 eurosh.

Pjesëtarët e patrullave kufitare do të përfitojnë nga 100 euro në muaj, ndërsa pjesëtarët e hetuesisë nga 75 euro shtesë në muaj.

Ekspertët reaguese dhe patrullat, që përbëjnë numrin më të madh të Policisë së Kosovës, do të marrin nga 60 euro shtesë në muaj, kurse



policëve që angazhohen për sigurinë e objekteve dhe menaxhim të operacioneve, do t'u ndahen nga 50, përkatësisht 40 euro shtesë të rrezikshmërisë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se kategorizimi dhe vlera e shtesave është bërë me kujdes të veçantë, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët

rreth punës dhe përgjegjësisë të Policisë së Kosovës. "Jemi dhe do të vazhdojmë të mbetemi të përkushtuar për përmirësimin e kushteve dhe pajisjeve të punës

për Policinë e Kosovës, në mënyrë që, krahas lehtësimit në punë, të ndikojmë në uljen e rrezikut gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë", ka deklaruar Kurti. Shtesat për rrezikshmëri, ka treguar Kurti, do të fillojnë të aplikohen nga paga e muajit nëntor.

Kryeministri i Kosovës ka thënë se me aprovimin e këtij vendimi pritet të përfitojnë afër 8 000 zyrtarë policorë.

Javë më parë pjesëtarët e Njësisë Speciale Intervenuese të Policisë së Kosovës dhe të Njësisë për Trajtimin e Mjeteve Eksplozive kanë protestuar para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar rishikimin e kategorizimit për rrezikshmërinë në punë.

Pagat e policëve të Kosovës nisin nga 210 euro në muaj për kadetët policorë dhe arrijnë mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm. E formuar 24 vjet më parë, Policia e Kosovës numëron mbi 9 000 pjesëtarë me grada të ndryshme.

Ata nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor.

Në QKUK për herë të parë kryhet një ndërhyrje e rrallë kirurgjike në hundë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Për herë të parë në Klinikën e Otorinolaringologjisë (ORL) të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është kryer një ndërhyrje e rrallë kirurgjike në hundë, me metodën e re FESS (Kirurgjia Endoskopike e Sinusëve).

Operacioni ka zgjatur mbi 3 orë dhe është kryer nga dr. Arsim Thaqi, i cili për shumë vjet me sukses të plotë ka specializuar dhe punuar në institucione prestigjioze në Gjermani, e që me

lejen dhe aprovimin e Ministrisë së Shëndetësisë, operacionin e ka kryer në mënyrë vullnetare, derisa mjeku është asistuar edhe nga specialistët dhe specializantët e Klinikës së ORL-së.

Dr. Thaqi është profesionist i shquar që nga diaspora së fundmi ka vendosur që në mënyrë vullnetare të operojë disa pacientë në QKUK, operacione këto për të cilat pacientët ishin referuar për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Pacienti E. D., i moshës 19-vjeçare, ishte me diagnozë Angiofibroma Juvenile (tumor i indit lidhor dhe enëve të gjakut në

hundë e pjesët përreth hundës). Para operacionit atij i ishin kryer të gjitha ekzaminimet e nevojshme diagnostike, përfshirë Tomografi të Kompjuterizuar (CT) dhe Rezonancë Magnetike (MRI).

Një operacion i tillë në institucionet jashtë vendit kushton rreth 15 mijë euro.

Bazuar në lejen e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, dr. Arsim Thaqi do të kryejë edhe disa operacione të tjera të komplikuara, me asistim edhe nga mjekët e Klinikës së ORL-së, për të cilët është mundësi e edukimit profesional.

Përrurohet shtatorja e Nënë Terezës edhe në Lisbonë

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ndodhet për vizitë në Portugali, ndërkaq bashkë me kryetarin e qytetit të

Lisbonës, Carlo Moedas, përruruan shtatoren e shenjtores shqiptare Nënë Terezës. "Kjo shtatore nuk është thjesht një vepër arti

por, mbi të gjitha, një urë që na lidh me idealin e përrjetshëm të shërbimit vetëmohues dhe dashurisë për të tjerët. Le të shërbejë

kjo statujë si një kujtesë e vazhdueshme e bamirëses më të madhe që njohu njerëzimi!", ka shkruar Osmani në "Facebook".



Vlera e investimeve të BQK-së në letra me vlerë dhe depozita arrin në 1.14 miliard euro

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Vlera investimeve në letra me vlerë dhe depozita arrin në 1.14 miliard euro, thuhet në raportin e bilancit të gjendjes së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për muajin tetor 2023. Sipas raportit, depozitat e Qeverisë së Kosovës deri në këtë periudhë janë rritur për 33 milionë euro. "Asetet e BQK-së në muajin tetor 2023 arritën vlerën prej 1.84 miliard eurosh, ndërsa

depozitat e Qeverisë së Kosovës janë rritur për 33 milionë euro dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave për 2 milionë euro", thekson BQK-ja.

Sa iu përket depozitave të BQK-së, deri në këtë muaj ishin 1.46 miliard euro.

"Vlera e këtyre investimeve në depozita dhe letrat me vlerë jashtë vendit më 31 tetor 2023 ishte 1.14 miliard euro. Depozitat në BQK deri në këtë muaj ishin 1.46 miliard euro, prej të cilëve 672.2 milionë euro janë nga Qeveria e Kosovës, 524 milionë

euro nga bankat komerciale dhe 163.9 milionë euro nga Agjencia Kosovare e Privatizimit", thuhet në raport.

Ndërsa asetet rezervë të BQK-së shënuan vlerën e 1.36 miliard eurove. "Asetet Rezervë në fund të muajit tetor 2023 shënuan vlerën e 1.36 miliard eurove e që janë për 15 milionë euro më të ulëta se në muajin paraprak. Kësaj rënie i ka kontribuar zvogëlimi i depozitave me jashtë vendit për 3.1 milionë euro dhe investimet në letra me vlerë për 11.3 milionë euro", thuhet në raportin e BQK-së.



Paraqitet rasti i parë këtë vit i gripit të shpezëve "Avian Influenza"



PRISHTINË, 16 NËNTOR - Është paraqitur rasti i parë në këtë vit i gripit të shpezëve "Avian Influenza" në fshatin Godancë të Shtimes, ka bërë me dije Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. "Pas konfirmimit të prezencës së sëmundjes, gripi i shpezëve 'Avian Influenza' në një fermë jokomerciale në Shtime, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë sot me datë 16.11.2023 ka nxjerrë 'Vendim' me nr AUV 01/619. Për masat e përgjithshme për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e sëmundjes Gripi i Shpezëve-

Avian Influenza. Zona në perimetër 3 km nga ferma në fshatin Godancë komuna Shtime, shpallet zonë karantine e ndalimit të lëvizjes së shpezëve. Ndërsa zona në perimetër 10 km shpallet zonë nën mbikëqyrje për hulumtim", ka njoftuar AUV. AUV menjëherë ka ndërmarrë masat ekzekutive për parandalim të përhapjes së këtij gripi. "Është bërë asgjësimi i pulave dhe shpezëve tjera në fermën e prekur, dezinfektimi i fermës dhe hapësirave rreth fermës. Ferma është ekonomi familjare (pula të oborrit). Jemi në

kontakte me praktikant veterinar, shoqatën fermerëve shpezëtar. Është urdhëruar ngritja e masave vetëmbrojtëse të biosigurisë në ferma. Aktualisht nuk kemi ndonjë rast tjetër të dyshimtë. Rasti është i izoluar është vetëm një fermë e prekur. Sëmundja është prezentë në shumicën e vendeve të BE-së dhe rajon. Në linjë me autoritetet e vendeve tjera AUV vendosë masat për parandalim të përhapjes sipas praktikave profesionale ndërkombëtare. Nuk ka asnjë ndalesë sa u përket produkteve të shpezëve", ka njoftuar AUV.

Cilësia e ujit në liqenin e Badocit është përmirësuar, por ende duhet të ulen vlerat e manganit

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se është duke vazhduar përcjellja e cilësisë së ujit të destinuar për pije në liqenin akumulues të Badocit. "Analizat e fundit laboratorike tregojnë se gjendja në liqe është qetësuar, cilësia e ujit është përmirësuar dhe pritet që në ditët në vijim të ulen vlerat e manganit në rrjet, sipas standardeve të parapara në Udhëzimin administrativ nr. 10/2021 - Cilësia e ujit për konsum nga njeriu. Ekipet e IKShPK-së janë në terren 24/7 dhe po bëhen çdo ditë analiza fiziko-kimike të ujit të prodhuar në fabrikën që



furnizohet nga Liqeni akumulues i Badocit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për

normalizimin e parametrave referent të ujit të pijshëm", ka njoftuar IKShPK-ja.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve të cilët furnizohen nga fabrika e ujit në liqenin e Badocit,

se uji mund të përdoret për pastrim, mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit si dhe për nevoja të tjera. "Uji në rajonet që furnizohen nga liqet akumulues Batllava dhe Ujmani mund të përdoren për pije pa përkufizim, shpëlarja e rezervuarëve të ujit në shtëpi dhe ndërtesat e banimit të përbashkët me qëllim pastrimi të manganit të shtresuar (përgjegjësi e amvisërive dhe këshillave të banimit), monitorimi dhe përcjellja e vazhdueshme për cilësinë e ujit po bëhet në tërë zonën e furnizimit nga liqeni i Badocit (shih hartën)", ka njoftuar IKShPK-ja.

Premtohet se furnizimi me energji elektrike do të jetë në nivel gjatë dimrit

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), respektivisht Termocentralin Kosova B, e ka vizituar ministrija e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, me bashkëpunëtorë, të cilët janë mirëpritur nga zv/kryeshefi ekzekutiv, Përparim Kabashi, i cili e ka njoftuar ministren Rizvanolli për gjendjen aktuale, rezultatet e arritura, si dhe sfidat dhe proceset nëpër të cilat po kalon KEK-u, me theks

të veçantë për implementimin me sukses të projekteve kapitale, si ai i dilatimeve në kaldatë e njësive B1 dhe B2 që, njëherësh, kanë qenë parakushte për implementimin e projektit të elektro-filtrave dhe pajisjeve për zvogëlimin e DeNOx-it, si dhe projekti i ndërrimit të zbarrave të gjeneratorit në njësinë B1 i cili, gjithashtu, ka përfunduar me sukses. U bë me dije se, përveç projekteve

kapitale, në dy njësitë e termocentralit Kosova B janë kryer edhe një sërë riparimesh të tjera, të cilat ishin planifikuar gjatë remonteve të rregullta vjetore të cilat kanë ndikuar në ngritjen e sigurisë së operimit. Sipas Kabashit, duke u bazuar në të gjitha përgatitjet e bëra në tri divizionet e prodhimit, nuk ka mëdyshje që furnizimi nga prodhimi vendor do të jetë në nivel edhe gjatë sezonit dimëror.



Historia e fotos ikonike nga Belfasti i trazirave

Nga: Dieter REINISCH, historian / RTÉ
Përkthimi (i pjesshëm) nga: *Telegrafi.com*

Janari i vitit 1973 ishte muaj i mbushur me ngjarje. Në atë muaj, Britania e Madhe dhe Irlanda iu bashkuan Komuniteti Ekonomik Evropian. Po atë muaj, parashtarakët luajalë [Ulster loyalism] e çuan konfliktin verior nëpër rrugët e Dublinit.

Një ditë, në vitin 1973, fotografi Colman Doyle kaloi pranë rrugës Agnes në Belfast të Irlandës së Veriut – pasi u nis të shkonte drejt qendrës së qytetit: “Dëgjova dikë duke shtëënë dhe më pas e pashë këtë grua. Ishte duke qëndruar në një qosh, ende duke e mbajtur atë armë, por ia dola ta bëjë foton pasi ajo ka shtëënë”.

Në një bisedë me autorin e RTÉ Brainstorm, Doyle këmbënguli se nuk e mban mend rrugën ku është realizuar fotoja, as datën e saktë, por pretendon se “nuk është e inskenuar”. Fotoja shfaq një grua me flokë të gjata, me një fustan me pika dhe që mban një pushkë.

Doyle, i cili nga gazetari i artist Liam Flynn është përshkruar si “doajen i fotozhurnalizmit në Irlandë”, ka punuar për The Irish Press. Një dekadë të karrierës e kaloi në Irlandën e Veriut, duke shkrepur, mes fotove të tjera, pamjet e parashutistëve britanikë që gjuanin kundër protestuesve të paarmatosur në Të dielën e përgjakshme.

“Ia ofrova foton shtypit irlandez”, kujton Doyle, “por redaktorët refuzuan ta shtypnin në gazetë. E konsideruan si të papërshtatshme foton që shfaqte një grua me armë”. Në fund të fundit, këto ishin vitet 1970. Një version përfundimisht u shtyp në librin e Colmanit të vitit 2004, *All Changed: 50 of Photographing Ireland* – në faqen 81 me titullin: “Një grua vullnetare e IRA-s në Belfastin Perëndimor, në shërbim aktiv me pushkën AR18”.

Doyle pohon se fotografia mbeti në arkivat e Irish Press-it. Kur shtypi i gazetës u ndërpre më 25 maj 1995, ndërtesa kryesore për një muaj mbeti e hapur dhe “njerëzit hynin e dilnin”. Ai beson se dikush e ka marrë kontrollin mbi negativët dhe se i ka çuar diku. Megjithatë, fotografia ka plot dy dekada që në forma të ndryshme ka qarkulluar.

Imazhi u spikat në propagandën e IRA-s Provizore [Provisional Irish Republican Army]. Sipas historianit John O'Neill, autor i *Belfast Battalion: A History of the Belfast IRA*, “ekziston një grup i atyre imazheve që përfshijnë të njëjtat figura të grave në skenarë të ndryshëm”, duke sugjeruar se ishte shkrepje propagande.



Një republikane nga Belfasti, e cila ishte aktive gjatë asaj kohe në vitet 1970, tha se “nëse do të kryhej një operacion, do të ishin të tjerët që do ta mbronin sulmuesin dhe se asnjë i huaj nuk do të lejohej të bënte foto. Kamera e tij do të konfiskohej, po të provonte”.

Një imazh propagandistik që shfaq tri gra të IRA-s, doli në *Republican News* me bazë në Belfast, në shkurt 1974, si dhe në kalendarin e Rezistencës Republikane të vitit 1974. Gruaja në të djathtë është e njëjta që shfaqet në foton e Doyleit, megjithëse Doyle thotë se ai nuk ishte fotografi i këtij imazhi. Fotoja e printuar në *Republican News* i përket një serie të fotografive propagandistike të bëra nga IRA Provizore.

Doyle pranon lidhjet e tij të ngushta me IRA-në Provizore: “Kam marrë leje nga Martin Meehani për të bërë foto të anëtarëve të IRA-s. Gruaja në foto ishte anëtare e njësisë në Ardoyne; ajo gjithashtu u shfaq në foto të tjera të njësisë së Meehanit”. Meehan ishte lider i IRA-së Provizore në zonën Ardoyne, i cili vdiq në nëntor 2007. “Kisha leje t’i bëja këto foto nga Martin Meehani, por shtypi irlandez më tha se nuk duhej të bëja foto propagandistike”, thekson Doyle. Doyle ishte i afërt me IRA-n Provizore. Në fillim të viteve 1970, ishte dukuri e zakonshme shfrytëzimi i gazetarëve dhe studiuesve nga IRA, ndërsa fotot shërbenin për të tërhequr gratë duke i portretizuar si luftëtare të barabarta me burrat.


Cilado qoftë origjina, fotografia që shfaq një grua me fustan të gjelbër e me pika të bardha, u bë një nga fotot më ikonike propagandistike të kohës trazirave dhe është shfaqur në gazetë, kalendarë, fanelle ... Muajt e fundit, imazhi u trajtua në Reddit, Facebook dhe Snopes ... (në rrjetin Facebook, edhe në gjuhën shqipe jepet ky version i rrejshëm për historinë e fotografisë: Kjo fotografi është bërë në Irlandë në vitin 1972, dhe tregon një vajzë duke qëlluar me


armën e të dashurit të saj, i cili u plagos në një betejë kundër ushtrisë britanike. Burri mbijetoi, u transportua në një vend të sigurt,

falë sakrificës së të dashurës së tij, e cila u përball me ushtarët anglezë derisa ajo u vra. Kur komandanti i batalionit britanik zbuloi se ai kishte

luftuar me një grua, ai urdhëroi ushtarët e tij të mos preknin trupin e saj dhe i lejoi irlandezët ta varrosnin. Thuhet se kanë dëgjuar komandantin anglez të thërrasë: ‘Mbretëresha nuk kujdeset për ne, siç kujdeset kjo grua për burrin dhe tokën e saj’. Fotoja u zgjodh si simbol për Ditën e Gruas në Irlandën e Veriut, e shoqëruar me këtë frazë: “Mos kini frikë të lidheni me një grua të fortë. Mund të vijë dita kur ajo do të jetë ushtria juaj e vetme” – shën. i përkth.)

Historia e vërtetë nuk do të tregohet derisa gruaja në foto të dalë përpara, gjë që nuk dëshiron ta bëjë – kjo sipas një miku të familjes së saj që foli me autorin e fotografisë. Tani në të 70-at e saj, gruaja jeton në Belfast dhe ka marrë pjesë në zbulimin e muralit që përshkruan foton e bërë nga Doyle. “Do të doja ta takoja edhe një herë”, thotë ai. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

'Dardanët' sot udhëtojnë drejt Bazelit, Krasniqi dhe Ajdini besojnë në fitore

Kosova, e motivuar pas fitores ndaj Izraelit, i ka përfunduar të enjten përgatitjet para udhëtimit në Bazelku. Sot (e premte) e zhvillon stërvitjen e fundit para ndeshjes ndaj Zvicrës. Futbollistët "dardanë", Ilir Krasniqi dhe Alban Ajdini, kanë shprehur optimizëm se do të shënojnë fitore ndaj zvicranëve

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 16 nëntor - Futbollistët e Përfaqësueses së Kosovës në futboll e kanë zhvilluar stërvitjen e fundit të enjten në Hajvali. Përzgjedhësi Primozh Gliha dhe ndihmësit e tij në këtë stërvitje i kanë dhënë përparësi aspektit teknik, derisa sot (e premte) ekspedita e Kosovës do të udhëtojë drejt Bazelit. Të shtunën përballet me Zvicrën në kuadër të Grupit I për kualifikimet në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Futbollisti Ilir Krasniqi është shprehur i kënaqur që ka qenë titullar në ndeshjen ndaj Izraelit. Ai e ka vlerësuar pozitive paraqitjen e Kosovës në këtë ndeshje që është zhvilluar në një terren të rënduar për lojë për shkak të reshjeve të

shumta të shiut. Lidhur me ndeshjen ndaj Zvicrës, Krasniqi e ka vlerësuar lart kundërshtarin, por ka paralajmëruar se me përkrahjen e bashkatdhetarëve synohet fitorja. "Stadiumi pritet të jetë pothuajse i mbushur me përkrahës shqiptarë. Na pret një duel shumë i vështirë, pasi dihet

niveli të cilin e ka Zvicra, por ne jemi shumë të motivuar, pasi e dimë se në stadium do ta kemi përkrahjen e madhe dhe shpresojmë në pikët maksimale. Gjasat? Matematikisht jemi ende në lojë, por dihet se do të jetë e vështirë. Ne do ta japim maksimumin, pastaj të shohim



DALIN NË SHITJE BILETAT E NDESHJES KOSOVË - BJELLORUSI, KËTO JANË ÇMIMET

Biletat për ndeshjen Kosovë - Bjellorusi kanë dalë në shitje, ka njoftuar Federata e Futbollit të Kosovës. "Dardanët" e presin Bjellorusinë në stadiumin "Fadil Vokrri" në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024". Biletat për këtë ndeshje, që zhvillohet më 21 nëntor në orën 20:45, mund të blihen përmes platformës online: "<https://eu.ebileta.al/biglietteria/listaEventiPub.do>". Çmimet e biletave janë si në vijim: Veri dhe Jug 5 euro, Lindje 10 euro, Perëndim 20 euro dhe VIP 80 euro.

pas përfundimit të ndeshjes", ka thënë Krasniqi. Për ndeshjen ndaj Zvicrës ka folur edhe futbollisti Alban Ajdini, i cili e vlerëson këtë përballje ndaj zvicranëve shumë të vështirë. "Do të jetë ndeshje e vështirë. Do të ketë shumë shikues. Do të jenë shumë shqiptarë aty, por na pret një sfidë shumë e vështirë", ka thënë Ajdini.

Ky i fundit është shprehur i lumtur që është bërë pjesë e "dardanëve": "Është një ndjenjë shumë e mirë. Jam shumë kënaqur që jam pjesë e Kosovës dhe do ta jap maksimumin për këtë fanellë. Pritja? Lojtarët më kanë pritur shumë mirë, stafi po ashtu dhe do ta jap maksimumin për këtë fanellë".

Shqipëria, gati për të realizuar ëndrrën e kualifikimit në 'Euro 2024'

"Epoka e re"

Tiranë, 16 nëntor - Kombëtarja e Shqipërisë sot (e premte) do të përballet me Moldavinë në ndeshjen e parafundit të kualifikueseve të "Euro 2024", e cila zhvillohet nga ora 18:00. Kjo ndeshje për kuqezinjtë është si finale për faktin se fitorja dhe barazimi i sigurojnë kualifikimin në Kampionatin Evropian. Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti ka konfirmuar se futbollistët shqiptarë janë gati për të realizuar ëndrrën e madhe dhe se nuk do të hyjnë në këtë ndeshje për barazim, por për fitore. "Besoj që



brenda ekipit jemi të njëjtë, presioni rritet. Por presioni transformohet në gjë të mirë në fushë dhe në një ndeshje ku jep gjithçka të ndihmon. Lojtarët e ri duhet të ndihmohen nga ne me eksperiencë. Edhe trajneri bën punën e tij. Jemi shumë

afër, por duhet të bëjmë edhe pak për të bërë ëndrrën realitet", ka thënë Gjimshiti. "Do të jetë shumë e vështirë, si ndeshjet e tjera. Do e përballojmë si gjithmonë. Nuk e harrojmë që në 'Air Albania' kishim pak raste deri në atë supergolën e

Asanit. Jemi përgatitur shumë mirë për të përballuar fushën dhe të shkojmë në të njëjtin drejtim. Igjithë ekipi nuk hyn për barazim, edhe nëse është ekip i dobët, nuk futet askush në fushë për barazim. Në natyrë e kemi të marrim 3 pikët në çdo lojë. Nëse nuk do të kishim këtë mentalitet do të kishim mundësi për të gabuar më shumë", ka deklaruar Gjimshiti. Për ndeshjen ndaj Shqipërisë ka folur edhe trajneri i Moldavisë, Sergei Kleschenko, i cili vlerësoi kuqezinjtë. Ai theksoi se skuadra e tij do të japë shpirtin në fushën e lojës. "E dimë që është një sfidë e vështirë, pasi jemi përballur me ta edhe në Tiranë, ku humbëm 2-0, por mendoj se meritonim një

barazim. Shpresoj që lojtarët të kenë nxjerrë mësimet e duhura dhe të reagojnë siç duhet. Në këto momente nuk mendojmë aspak për Çekinë, pasi më mirë të vdesim në fushë ndaj Shqipërisë, sesa të lëmë gjithçka për sfidën në Pragë. Dua të shoh të njëjtin shpirt gare si në ndeshjen ndaj Polonisë, kur përmbysëm gjithçka në pjesën e dytë. Do të kemi edhe përkrahjen e fansave tanë, që kanë treguar se janë gjithmonë aty dhe bëhen një lojtar i 12 për ne", u shpreh Kleschenko. Shqipëria është e para në Grupin E më 13 pikë, kurse Moldavia është e katërta më 9 pikë. Ndeshja mes këtyre dy kombëtarëve fillon nga ora 18:00.

Kosova U21 synon fitore ndaj Bullgarisë

Prishtinë, 16 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në futboll sot (e premte) përballet me Bullgarinë në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë me fillim nga ora 13:00. "Dardanët" gjatë ditëve të fundit kanë punuar në aspektin taktik dhe motivues. Pavarësisht prej mundësive në skuadër, Kosova kundër Bullgarisë do të luajë për fitore. Përzgjedhësi Afrim Tovërlani në prag të kësaj ndeshjeje ka deklaruar se e kanë analizuar kundërshtarin dhe kanë identifikuar pikat kryesore të

Bullgarisë. "Kundërshtarin e njohim sepse ndeshjen e fundit e kemi zhvilluar ndaj tyre në Bullgari. E dimë cilat janë pikat kryesore në dy repartet, sulm dhe mbrojtje. Futbollisti kryesor i tyre është Nikollov, i cili luan si sulmues dhe njëherësh është futbollisti më i rrezikshëm, çka do të thotë se ne duhet të kemi më shumë kujdes ndaj tij. Gjithmonë hyjmë për fitore. Unë asnjëherë nuk flas për rezultate, prandaj më mirë do ta presim fundin e ndeshjes", ka thënë Tovërlani. Ndërsa motivi te futbollistët e

Kosovës është i lartë e, po ashtu, edhe atmosfera është tejet e mirë. "Edhe pse kemi pasur pak ditë për stërvitje gjithçka ka shkuar mirë dhe të gjithë lojtarët kanë dhënë maksimumin. Nuk kemi qenë kurrë më të motivuar se këto ditë dhe gjithçka po shkon mirë. Atmosfera është shumë e mirë. Kanë ardhur disa futbollistë të rinj, por shumë shpejt janë përshtatur me grupin. Në këtë ndeshje ne e njohim më mirë kundërshtarin, por edhe ata na njohin më mirë për shkak të ndeshjes së kaluar që kishim,

por shpresojmë se do ta kemi edhe përkrahjen e tifozëve dhe ne do ta japim maksimumin brenda në fushë", ka theksuar Veton Tusha. Valton Behrami, i cili për herë të parë i është bashkuar ekipit kombëtar, foli për atmosferën e mirë në ekipin e Kosovës, derisa ka thënë se beson në fitore. "Për mua kjo është hera e parë që jam pjesë e Kosovës U21 dhe jam shumë i kënaqur me kombëtarin dhe qysh kam pritur ka qenë edhe më mirë. Nesër shpresoj në fitore. Ne luajmë vetëm për fitore. Kundërshtari



është i fortë fizikisht, por nesër do të hyjmë në fushë sikur të hyjmë në luftë dhe do ta arrijmë fitoren. Dardanët i ftoj të na përkrahin në stadium. Ne jemi të rinjtë të cilët do të luajmë për Kombëtares A. Ata na japin kurajë dhe fuqi për të fituar. Nesër ne luajmë edhe për Dardanët, jo vetëm për vete", ka deklaruar Behrami.

Publikohet plani për ndërtimin e tribunës veriore në stadiumin 'Bajram Aliu'

SKENDERAJ, 16 NËNTOR - Komuna e Skenderajt ka publikuar planet për projektin e ndërtimit të qytetit, ku përfshihet edhe ndërtimi i tribunës veriore të Stadiumit "Bajram Aliu". Komuna e

Skenderajt e ka konfirmuar një gjë të tillë përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". "Po fillon tani transformimi i pjesës së frekuentuar të qytetit tonë - Bulevardi "Ilaz Kodra", ku ka filluar rënimi i

objekteve ekzistuese, për t'u zëvendësuar me objekte moderne, në të cilat operatorët biznesorë do të kenë kushte shumë më të mira ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike, ndërsa pjesë e

këtij projekti është edhe ndërtimi i tribunës veriore të Stadiumit 'Bajram Aliu', e tërë kjo në funksion të zbatimit të planit rregullativ të qytetit të Skenderajt", thuhet në njoftimin e komunës.



Presidenti i Federatës Italiane të Volejbollit viziton Kosovën

PRISHTINË, 16 NËNTOR - Federata e Volejbollit e Kosovës të enjten ka pasur mysafirë të veçantë. Për herë të parë në Kosovë ka qëndruar presidenti i Federatës Italiane të Volejbollit (FIPAV), Giuseppe Manfredi, i shoqëruar nga zëvendës-presidenti i Konfederatës Evropiane të Volejbollit (CEV), Renato Arena. Në selinë e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Manfredi e Arena janë pritur fillimisht edhe nga krerët e lëvizjes olimpike në Kosovë, presidenti Ismet Krasniqi e sekretari i përgjithshëm Besim Aliti.

Krasniqi dhe Aliti i kanë falënderuar për vizitën që i kanë bërë Federatës së Volejbollit në Kosovë. Gjatë vizitës së tyre në KOK, ata janë shoqëruar nga presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi dhe anëtarja e bordit të FVK-së, Halime Fetahu.

Krasniqi ka folur për raportet e mira që KOK-u i ka me Federatën e Volejbollit duke theksuar se është e



rëndësishme që Federata Italiane ka, po ashtu, raport të mirë me Federatën e Volejbollit të Kosovës. Ndërsa presidenti i FIPAV, Giuseppe Manfredi, ka thënë: "Nuk kam ardhur të flas shumë, por të punojmë. Trajnerët tanë më të mirë të sektorit të rinjve janë këtu në Kosovë dhe do të punojnë me djemtë e vajzat e reja këtu. Ne nuk flasim shumë. Nuk jemi këtu për të thënë shumë fjalë, por ato

fjalë që i themi, jemi këtu për t'i konkretizuar e realizuar". Kënaqësinë e tij për vizitën në Kosovë e ka treguar edhe zëvendës-presidenti i CEV, Renato Arena, për të cilin është hera e dytë që e viziton vendin tonë. Pas takimit me krerët e KOK-ut, Manfredi e Arena, e kanë vazhduar protokollin, sipas agjendës së paraparë, gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë.

Bostoni fiton duelin ndaj Philadelphias, triumfojnë dhe Milwaukee e Phoenixi

PHILADELPHIA, 16 NËNTOR - Bostoni ka fituar ndeshjen ndaj Philadelphias (117-107) në duelin mes dy skuadrave kryesuese të renditjes në Konferencën e Lindjes. Fitore e merituar për Celticsin, që udhëheq i vetëm. Për miqtë u dalluan Tatum me 29 pikë e White me 27 pikë. Fitoi edhe Dallasi, që falë 31 pikëve të Hardawayt, mundi 130-118 Washingtonin. Nuk zhgënjeu skuadra e Milwaukeees, që falë 37 pikëve të Lillardit dhe 30 të Beasleyt, mundi me rezultat 128-



112 Toronton në fushën e skuadrës kanadeze. Pas tri fitoresh radhazi ndalet ekipi i Lakersave, që u mund me shifrat 125-110 në fushën e vet nga Sacramento. Sabonis me 29 pikë si dhe Hueter e Fox me nga 28 pikë secili shkëlqyen për miqtë. Fitore të rëndësishme për renditje korri ekipi i Phoenixit, që e mundi

me rezultat 133-115 Minesotan, ndeshje ku u dalluan Bookerit e Duranti, me nga 31 pikë secili. Fitore në sekondat e fundit arriti ekipi i Orlando, që mundi Chicagon (96-94), ndërsa New Yorku mundi Atlantan (116-114), ndeshje ku u dallua Randle me 29 pikë e 11 rebounde.

REZULTATET

Washington - Dallas	117-130
Atlanta - New York	114-116
Philadelphia - Boston	107-117
Toronto - Milwaukee	112-128
Chicago - Orlando	94-96
Phoenix - Minnesota	133-115
Lakers - Sacramento	110-125
Portland - Cleveland	95-109

Reali dhe tri klube angleze në garë për Davies

Alphonso Davies është tashmë në një nga skuadrat më të mëdha në botë te Bayern Muncheni, por kur Real Madridi të

thërret, është e vështirë t'i rezistosh. Sipas asaj që raportohet nga "90min", anëtori i majtë duket se dëshiron të largohet nga

Bavaria në verë për t'u transferuar në Spanjë te "Los Blancos". Por, në fakt, pas tij nuk ndodhet vetëm Reali. Sipas raportimit të

mediumit në fjalë, për anëtorin kanadez janë edhe tri klube angleze. Chelsea, Liverpool dhe Manchester City kanë

shfaqur interesim për t'i fituar shërbimet e tij, por për Davies ka vetëm një emër në kokë, atë të Real Madridit.

SHKURT

Khaka në histori të Kombëtares së Zvicrës

Mesfushori me prejardhje shqiptare, Granit Khaka, ka hyrë në histori të kombëtares së Zvicrës. Ai zyrtarisht ka më së shumti paraqitje për "helvetikët". Këtë rekord ai e arriti në ndeshjen e së mërkurës ku skuadra e drejtuar nga trajneri Murat Yakin barazoi 1-1 kundër Izraelit. Kapiteni zviceran i ka deri më tani 119 paraqitje. 31-vjeçari është pjesë e kombëtares A nga viti 2011. Ka realizuar 11 gola dhe ka bërë shtatë asistime. Granit Khaka me Zvicrën ka luajtur në tre Kampionate Botërore (2014, 2018 dhe 2022), ndërsa dy herë ka marrë pjesë në Kampionate Evropiane (2016 dhe 2020).

Antwerpi zgjedh golin e Mujës më të bukurin për muajin tetor

Sezoni i ri ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme për Arbnor Mujën. Si fillim ftesa me Kombëtaren shqiptare dhe dy paraqitje të mira në shtator, kundër Çekisë dhe Polonisë. Më pas 14 prania në kampionat dhe 4 gola të shënuar tek Antwerp në Belgjikë. Tetori ishte një muaj shumë pozitiv, pasi Muja gjeti golin e parë në grupet e Ligës së Kampionëve, i pari edhe për ekipin në këtë kompeticion. Klubi belg, përmes faqes zyrtare në "Twitter", ka për zgjedhur golin e Mujës si më të bukurin e muajit tetor. Muja i shënoi Shakhtar Donetskut në ndeshjen e dytë në grup, pavarësisht se ukrainasit e përmbysën dhe fituan 3-2.

Liverpooli rikthen interesimin për Mbappen

Kylian Mbappe është sërish në shënjestër të Liverpoolit dhe ky nuk është lajm aspak i mirë për Real Madridin që synon transferimin e sulmuesit francez që një kohë të gjatë. Kontrata e Mbappes me Paris Saint-Germainin skadon në verë e ardhshme dhe klubet e mëdha evropiane do të përpiqen ta transferojnë atë. Mediumi francez "L'Equipe" shkruan se e ardhmja e Mbappes do të mbetet e pazgjidhur dhe pezull deri në muajt e parë të vitit 2024.

Rodri: Haalandi e meritoi 'Topin e Artë' më shumë se Messi

Mesfushori spanjoll Rodri këtë vit u rendit i pesti në renditjen për trofeun e "Topit të Artë". Ky trofe u fitua nga Lionel Messi, por 27-vjeçari spanjoll që luan me Manchester Cityn nuk është dakord me rezultatin final. "Ky ishte një sezon i jashtëzakonshëm për mua dhe këto renditje janë një vlerësim për mua. Jam me këmbë në tokë, pasi e di që mund të luaj në këto nivele, ndaj pretendoj më shumë nga vetja", ka thënë Rodri. "Të jem në këtë renditje është një nder, por nuk do t'ia kisha dhënë këtë trofe Messit. Është diçka e ndërlikuar. Botërori është event i madh në botë. Nuk ka dyshime për këtë, por ai aktivitet është i shtrirë në një muaj kohor", u shpreh Rodri. "Ndërsa një sezon shkon në 7-8 muaj. Erling Haaland është një djalosh që sezonin e kaluar i theu të gjitha rekordet si golashënues. Të mos harrojmë se ishte në sezonin e tij të parë me Manchester Cityn dhe fitoi gjithçka që kishte mundësi. Unë do t'ia kisha dhënë atij trofeun e "Topit të Artë" edhe pse këtë gjë nuk duhet ta them unë. Është shoku im i skuadrës te City dhe do të më pëlqente nëse do ta kishte fituar këtë trofe", u shpreh spanjollit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ARNENI” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810232504 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ARNENI” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810232504 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ARNENI” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 810232504 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “MEKANIKU-Z.H” Sh.P.K. me seli në Rahovec, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810733388 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “MEKANIKU-Z.H” D.O.O. od Rahovec, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810733388 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “MEKANIKU-Z.H” L.L.C. with headquarters Rahovec, has come to the decision to quit its business: 810733388 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Emri i biznesit B5 Inframain SH.P.K. si dhe me emër tregtar B5 Infrastructur&Maintance me Numër Unik Identifikues: 811574583, ka marr vendim për zvogëlim të kapitalit nga 2000.000 në 20.000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kaltrina Strela shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hivzi Sylejmani” Fushë Kosovë.

-Fidan Sheremeti shpall të pavlefshme dëftesat e klasës I,II,III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë “Arkitekt Sinani”.


-Golden mix SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811499848.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Drejtoria e Arsimit
05NR070-7206
Datë 16.11.2023

Në bazë të nenit 5, të Rregullores mbi ndarjen e bursave për nxënës dhe student të Komunës së Suharekës 01-Nr-016-7790 të datës 31.01.2019, Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores 01-nr-016-7543 të datës 29.01.2021, Drejtoria Komonale e Arsimit në Suharekë në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës 01 Nr.016-72066 të datës 15.11.2023 shpall këtë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënës dhe student për vitin shkollor 2023/2024

Drejtoria e arsimit për vitin shkollor 2023/2024, shpall konkurs për 420 bursa (270 bursa për student dhe 150 bursa për nxënës të shkollave të mesme të larta). Bursat ndahen vetëm për student dhe nxënës që janë banor të përhershëm të Komunës së Suharekës dhe që i vijojnë mësimet/studimet themelore në shkollat përkatësisht Universitetet publike të Kosovës.

Vlera e bursës për një vit akademik- shkollor do të jetë:

- Për student/e 50 € në muaj për 10 muaj
- Për nxënës /e 25 € në muaj për 10 muaj

Kushtet dhe kriteret:

- Të ketë të regjistruar vitin shkollor/akademik për të cilin jepet bursa.
- Të mos jetë shfrytëzues/e i ndonjë burse tjetër e cila dëshmohe me vërtetim nga fakulteti ku studion.
- Për kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultet të kenë dëshminë e suksesit të vitit paraprak (diploma dhe dëftesa e vitit të fundit të shkollës së mesme të lartë)
- Gjendja ekonomike sociale e familjes e cila dëshmohe me vërtetim nga Qendra për punë sociale.

Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve:

-Fëmijët e dëshmorëve të cilët janë student dhe nxënës të shkollave të mesme të larta, do të ju ndahet bursa jashtë kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, por të gjithë studentët dhe nxënësit e kësaj kategorie janë të obliguar ta sjellin vërtetimin e regjistrimit të semestrit për vitin akademik të studimeve për të cilin ndahet bursa.

Kriteret dhe prioritetet për fitimin e së drejtës në bursë janë si më poshtë:

1. Nota mesatare 9.5 deri në 10.00, në fakultet, vlerësohen me 30 pikë,
2. Nota mesatare 8.5 deri në 9.49 në fakultet, vlerësohen me 20 pikë,
4. Nota mesatare 7.5 deri në 8.49 në fakultet, vlerësohen me 15 pikë,
5. Nota mesatare 7 deri në 7.49 në fakultet, vlerësohen me 5 pikë.
6. Nota mesatare 6 deri në 6.99 në fakultet, vlerësohen me 3 pikë
7. Suksesi i shkëlqyeshëm 4.5 deri në 5 në shkollat e mesme të larta vlerësohet me 25 pikë,
8. Suksesi shumë mirë 3.5 deri në 4.49 në shkollat e mesme vlerësohet me 15 pikë,
9. Suksesi i mirë 3 deri në 3.49 në shkollën e mesme vlerësohet me 8 pikë,
10. Suksesi i mjaftueshëm 2 deri 2.99 në shkollën e mesme vlerësohet me 3 pikë,
11. Për familjet që kanë 2 (dy) studentë nga e njëjta familje 10 pikë,
12. Për familjet që kanë tre studentë (vëllezër-motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë të tjera.
13. Për kandidatët e SHML që kanë dy nxënës nga e njëjta familje vlerësohen me 10 pikë.
14. Për familjet që kanë tre (3) nxënës në shkollat e mesme të larta (SHML), (vëllezër -motra) nga e njëjta familje i shtohen edhe 5 pikë.
15. Pikët e studentëve janë të vlefshme vetëm për kategorinë e studentëve dhe pikët e nxënësve llogariten vetëm për kategorinë e nxënësve të të njëjtës familje.
16. Gjendja ekonomike- financiare (rastet sociale) vlerësohen me 30 pikë.
17. Studentët/ nxënësit të cilët nuk kanë asnjërin prind në jetë, fitojnë bursën pa kriterë të përcaktuara me rregullore, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
18. Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë, e cila vërtetohet me certifikat të vdekjes ose me deklaratë të bashkësisë familjare.
19. Fëmijët me dy prindërit me nevoja të veçanta me dëshmi mjekësore fitojnë bursën pa kriterë të përcaktuara me rregullore, me kusht që të kenë të regjistruar vitin e ri akademik (dëshmi vërtetimi për regjistrimin e semestrit),
20. Fëmijët me nevoja të veçanta, ndërsa të dy prindërit janë në gjendje normale vlerësohen me 10 pikë.
21. Fëmijët me njërin prind me nevoja të veçanta dhe vetë fëmija me nevoja të veçanta vlerësohen me 15 pikë.
21. Fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe ish të dënuarve politikë, vlerësohen me 8 pikë,
19. Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së, vlerësohen me 10 pikë,
20. Studentët/et, nxënësit/et të cilët nuk kanë asnjërin prind të punësuar, e cila vërtetohet me dëshmi/vërtetim nga Enti i punësimit dhe nuk krijojnë të ardhura nga ndonjë veprimtari tjetër dobi prurëse, vlerësohen me 15 pikë, por këto pikë nuk llogariten edhe për studentët/et, nxënësit/et, të cilët marrin asistencë sociale.

22. Fëmijët e viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë vlerësohen me 12 pikë,
23. Fëmijët e veteranëve të luftës të UÇK-së vlerësohen me 8 pikë.

24. Nga e njëjta familje mund të përfiton bursë vetëm një student/e dhe nxënës/e, pa marrë parasysh kategorinë e tyre.

25. Nxënësit/et, që kanë poentim të barabartë pas shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë nxënësit/et që kanë distancë më të largët nga institucionet shkollore.

Përfitues të bursës nuk mund të jenë këto kategori:

1. Studentët/et dhe nxënësit/et, që kanë dy prind të punësuar në institucionet publike (shtetërore).
2. Studentët/et dhe nxënësit/et, që prindërit e tyre kanë biznes të regjistruar dhe aktiv, e cila dëshmohe me vërtetim nga Qendra e regjistrimit të biznesit.
3. Përfitues i kësaj burse nuk mund të jetë studenti/nxënësi, nëse brenda vitit të njëjtë fiskal ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e arsimit.
4. Nëse vërtetohet se studenti i cili është përfitues i bursës nga komuna, merr bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/ajo obligohet ta kthejë bursën.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kërkesa sipas formës së përpiluar nga Drejtoria e arsimit;
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2023/24 (origjinale);
- ✓ Certifikata e notave (origjinale);
- ✓ Vërtetimin se studenti/ja nuk është përfitues/e i/e bursës universitare;
- ✓ Ekstraktin e lindjes;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit;
- ✓ Vërtetim mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale për vitin 2023/24 ;
- ✓ Për studentët e regjistruar në vitin shkollor/akademik 2023/24, kopjet e vërtetuara të dëftësave dhe të diplomës së shkollës paraprake.

Afati i konkurrit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data 17.11.2023 deri më datë 01.12.2023.

Dokumentet dorëzohen sipas afatit të konkursit dhe nuk pranohet plotësim i dokumentave pas mbylljes së konkursit.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara në Komunën e Suharekës, zyra nr. 1 çdo ditë pune prej orës 8:00 deri më 16:00



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

